



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 07

Prishtinë, më 09.03.2015, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Valdete Bajrami, Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Slavko Simiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Edona Tolaj – YIHR, Selvete Gërxhaliu – GDNJD, Lejla Selimi – OSBE, Elvine Sefiu-Tribuna Chanel, Florina Merovci-ZPRK, Behxhet Shala-KMDLNJ, Visar Bivolaku-EUO/EUSR, Sehida Miftari-OSBE, Sakibe Jashari- Ambasada Zvicerane, Valdete Berisha-Kosova sot dhe Drita Vitia-Kosova sot.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve nr. 04, 05 dhe 06/2015;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nr. 04, 05 dhe 06/2015

Kryetarja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 28.01.2015, 10.02.2015 dhe 16.02.2015, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit.

Kryetarja- Para Komisionit prezantoi punën e Panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidateve për Avokat të Popullit, tha se ka pasur 21 aplikantë, prej tyre 19 janë paraqitur në intervistë, kurse dy kandidate nuk i janë përgjigjur ftesës për intervistim.

I tërë procesi ka qenë i rregullt dhe gjithçka ka shkuar sipas procedurave, në fund të intervistimit kemi bërë poentimin e kandidatëve, secili në mënyrë individuale dhe ka hedhur fletëvotimin në kuti, ku pastaj është bërë numërimi.

Ajo paraqiti raportin e panelit rekrutues dhe listën e kandidatëve, sipas pikëve të fituara, ku më së shumti pikë kanë grumbulluar Veton Vula: 88 pikë, Mazllum Barali: 79 pikë, Shqipe Ibraj-Mala: 78 pikë dhe Suzana Novobërdaliu: 78 pikë.

Sipas ligjit duhet t'i procedojmë tre emrat e kandidatëve që kanë më së shumti vota. Mirëpo në këtë rast kemi kandidaten e tretë dhe të katërt me numër të barabartë të pikëve, rregullorja nuk e ka paraparë këtë rast se si të veprohet, prandaj a jeni dakord të procedojmë rekomandimin për Kryesi të Kuvendit me 4 kandidatë?

Ajo, po ashtu, tha se anëtari i Komisionit nga komuniteti serb nuk ka marrë pjesë në panel. Kjo nuk ka të bëjë për çështjen e punës së drejtpërdrejtë në Komision, por është çështje e refuzimit të përgjithshëm të pjesëmarrjes së këtij komuniteti në institucione.

Mytaher Haskuka- Tha se pajtohet që të procedohet lista me 4 emra, pasi që kandidati i tretë dhe i katërt kanë pika të barabarta, sepse forma e propozuar në bazë të shkronjave të alfabetit, pra sipas mbiemrit është mjaft diskriminues dhe dihet se bëhet fjalë për një pozitë të rëndësishme si e Avokatit të Popullit.

Salihe Mustafa- Tha se ligji ka mangësi dhe nuk e parasheh rastin për kandidatët me pikë të barabarta dhe nuk e precizon për cilën kohë nuk duhet më qenë pjesë e partive politike, pasi që të gjithë e dimë që disa prej tyre kanë qenë në parti politike, mendoj që Komisioni duhet të procedojë të katër kandidatët.

Kujtim Paçaku- Tha se nëse nuk e shkelim ndonjë rregullore dhe nuk bëjmë asnjë gabim atëherë unë e përkrahu mendimin që të dërgojmë 4 kandidatët edhe pse edhe kandidatët që kanë mbi 70 pikë kanë qenë të shkëlqyeshëm.

Mexhide Mjaku-Topalli- Tha se edhe pse unë nuk isha pjesë e panelit, besoj në vendimin e qëlluar që keni marrë, jeni bazuar në shumë kritere dhe mbështes vendimin tuaj që këta kandidatë të dërgohen në Kuvend.

Kryetarja konstatoj që Komisioni miraton Raportin e Paneli rekrutues për Avokatin e Popullit dhe njëherit komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, duke u bazuar në nenin 8.7 të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe në faktin se dy kandidatet e radhitur në vendin e tretë për nga pikët vlerësuese, kanë numër të barabartë të pikëve, si dhe në faktin se Rregullorja për Zgjedhjen dhe Shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të Zëvendësve të Avokatit të Popullit, nuk i ka përcaktuar veprimet procedurale për rastin kur kandidatët në vendin e tretë, kanë numër të barabartë të pikëve, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2015, e miratoi Raportin e Panelit dhe vendosi që Kuvendit t'ia rekomandojë për votim kandidatët për Avokat të Popullit, si vijon:
Veton Vula, Mazllum Baraliu , Shqipe Ibraj-Mala dhe Suzana Novobërdaliu.

4. Të ndryshme

Kryetarja tha se Komisioni po ashtu ka pranuar një petition nga 92 punëtorët e Hotel Grandit dhe për këtë duhet të formohet një grup punues që të merret më hollësisht me shqyrtimi e këtij peticioni.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Formohet grupi punues për shqyrtimin e petitionit të punëtorëve të Hotelit Grand me këtë përbërje:

Lirije Kajtazi, Mytahir Haskuka dhe Kujtim Paçaku.

Propozohet që në mbledhjen e ardhshme të jetë i pranishëm edhe Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe përfaqësuesit e punëtorëve të Hotelit Grand.

Mexhide Mjaku –Topalli- Njoftoi Komisioni për tryezën e organizuar nga Handikos dhe USAID, ku kishin marrë pjesë përfaqësues nga Kuvendi i Kosoves, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe kryetari i Handikos-it Afrim Maliqi.

Kryesisht ky debat kishte të bënte me procesin elektorale për qasjen e personave me aftësi të kufizuar, pra të jenë të barabartë në jetën publike dhe politike.

Po ashtu ajo njoftoi edhe për takimin që grupi punues për shqyrtimin e petitionit për zbardhjen e fatin të Ukshin Hotit, ka pasur me kryetarin e Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur, z. Prenk Gjetaj dhe propozoj të mbahet një takim edhe me shoqatën e familjareve të personave të zhdukurve dhe pastaj do të vijmë më një rekomandim.

Kryetarja tregoi që edhe Kryetari i Kuvendit ka realizuar një takim më përfaqësuesit e familjarëve të të pagjeturave, mirëpo ajo beson që grupi punues nuk do të vonohet më rekomandimin.

Kujtim Paqaku- Tha se sipas planit të punës është paraparë të bëhen vizita në disa komuna, gjegjësisht komitetit për komunitete, më intereson të dijë se kur do të realizohen vizitat dhe në cilat komuna do të shkohet?

Kryetarja- Tha se kemi bërë ndarjen e punëve nëpër muaj, por se për cilën ditë do të realizohen vizitat nëpër komuna saktësisht vendosim ne, por i kemi disa çështje ende të hapura si zgjedhjen e Avokatit të Popullit, kemi tri peticione me rëndësi që duhet t'i shqyrtojmë dhe monitorimin e ligjit për të verbrit.

Salihe Mustafa- Tha se është mirë të fillohet sa më shpejt me punën për monitorimi e ligjit për të verbër.

Mexhide Mjaku –Topalli- Pyeti se a ka marrë pjesë ndokush nga ky Komision, në Parlamentin Evropian për festën e 8 Marsit, ku u organizua një konferencë, pjesëmarrja e femrës në politikë, në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, e drejtuar nga Ulrike Lunacek, është organizuar nga sesioni për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore.

Kryetarja - Tha nëse është duke u biseduar për takimin e njëjtë, përfaqësimi është bërë nga gratë deputete të katër partive më të mëdha, e që janë caktuar nga shefat e grupeve parlamentare.

Mytaher Haskuka u interesua të dijë se deri ku ka arritur të procedohet peticioni kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike dhe kur pritet të diskutohet në Kuvend.

Me kërkesë të kryetares, koordinatori i Komisionit jep sqarim, që kryesia i ka shqyrtuar rekomandimet që i ka bërë Komisioni, por ato kanë implikime buxhetore. Prandaj ia ka drejtuar Komisionit për buxhet që të bëjë një raport për implikimet buxhetore të atyre rekomandimeve dhe pastaj të vendoset se si t'ë procedohet më tutje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi